


NE GJITHMONË DO TË JEMI KËTU



VENDIMARRJA ËSHTË E DEMOS-IT

RELIONA (11), FATJONA (10), FLAMUR (11), ERIS (10), AULONA (11), RIONA (10), ERA (10),
MAISA (10), ELIZA (10)



Ne jemi të lirë të shprehim atë që mendojmë. A thua vallë kush na mundëson këtë liri? Për ta kuptuar lexojeni këtë artikull

Shteti ynë Kosova është vend demokratik, pasi që ka: liri, barazi, drejtësi, zgjedhje të lira, respektim të të drejtave të njeriut, bashkëpunim, tolerancë, etj. Demokracia është formë e qeverisjes, që nënkupton të drejtat e barabarta të popullit për të marrë pjesë në vendimmarrje. Kosova është shtet i ri në Evropë, prandaj ne duhet të ndihmojmë dhe të kontribuojmë në vendin tonë. Gjithmonë duke marrë parasysh elementet e demokracisë, që i përmendem më lart. Janë dy forma të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli direkt i merr vendimet. Ndërsa, ajo përfaqësuese është kur populli i zgjedh përfaqësuesit e vet dhe ata marrin vendime në emër të tij. Mirëpo, demokracia përfaqësuese ka dy sisteme, ato janë: sistemi parlamentar dhe presidencial.

Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar. Prandaj, populli në procesin zgjedhor i voton kandidatët për deputetë. Me një fjalë, deputetët janë përfaqësuesit e populli.

Në vendet demokratike ka shumë gjëra të mira dhe të drejtat e popullit janë të barabarta pa dallim race, etnie, gjinie, moshe, besimi apo feje. Të drejtat tona në demokraci janë të barabarta, si për shembull: e drejta e të shprehurit, e drejta e të ushqyerit, e drejta e emrit,

e drejta e shkollimit, e drejta e kujdesit shëndetësor, e drejta e familjes, e drejta e lojës, etj. Të dashur lexues, mesazhi për ju është ky: pa barazi, drejtësi dhe liri nuk ka demokraci.



Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të punojnë për vendin e tyre



Shokë e shoqe përgjithmonë

ZGJEDHJET JANË ZEMRA E DEMOKRACISË

YLLZA (10), MUHARREM (10), EGZON (11), AURELA (11), ANITA (10), LEDRI (10), JULINDË (10),
MUSLI (10)

A e dini se pse zgjedhjet janë zemra e demokracisë? Këtë përgjigje mund ta mësoni në artikullin më poshtë

Me anë të zgjedhjeve, populli e ka të drejtën të zgjedh deputetët, të cilët do ta përfaqësojnë vendin tonë, Kosovën. Zgjedhjet janë zemra e demokracisë, sepse përmes tyre secili qytetar ka të drejtën për të votuar dhe për të zgjedhur personat, të cilët do të udhëheqin me vendin. Ndonëse, ne i përdorim votat në përditshmëri, marim shembull përmes votave e zgjedhim kryetarin e klasës, të drejtën për të votuar në zgjedhjet shtetërore e kemi prej moshës 18 vjeçare. Kjo për arsye se, në këtë moshë jemi më të pjekur dhe e dijme më mirë se si duhet të jenë personat që duhet t'i votojmë. Votimi në Kosovë është përgjegjësi e çdo qytetari, i cili dëshiron të kontribuojë për shtetin e tij. Prandaj, iu ftojmë edhe juve që kur ta arrini këtë moshë të votoni, sepse vota juaj bën ndryshim në shtetin tonë.




Votuesit e së ardhmes



Demokracia është liri dhe paqe



Votimi është përgjegjësi e çdo qytetari




Të gjithë e kemi të drejtën e votës nga moshja 18 vjeçare



Me anë të votave ne i zgjedhim përfaqësuesit e shtetit tonë



Demokracia shumëngjyrëshe



Mbledhja e deputetëve



Kushtetuta e Kosovës



Fjona gjatë punimit të artikullit



Dorina dhe Bleardi duke bashkëpunuar



Duke diskutuar për artikullin




Kështu dukej tavolina e punës së gazetarëve të zellshëm



Pa dallim race, feje, gjinie dhe kombi

KUVENDI YNË

ADRIATIK (11), ELISONA (10), ENITA (11), AURORA (10), AURESA (11), FJONA (10), DIANA (11),
DORINA (11), BLEARD (11)



Më poshtë do të lexoni një artikull për Kuvendit e Kosovës, të shkruar nga ne gazetarët e vegjël

Demokracia është sistem i qeverisjes, në të cilin qytetarët e atij vendi kanë liri, të drejta të barabarta, barazi, etj. Ky sistem funksionon në bazë të disa elementeve, ku element themelor janë zgjedhjet. Përmes zgjedh-

institucioni, zgjedhja e Presidentit të shtetit, etj. Funksionet më të rëndësishme të Kuvendit janë funksioni përfaqësues, sepse e përfaqëson popullin, funksioni legjislativ, sepse i bëjnë ligjet dhe funksioni kontrollues, sepse e kontrollojnë Qeverinë.



Kuvendi ynë ka 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të komunitetit shqiptar, kurse 20 janë prej komuniteteve tjera si: serbë, ashkalinjë, turq, romë, boshnjakë, etj. Ne ndihemi shumë mirë, pasi që shteti ynë është demokratik. Megjithatë, ne mendojmë se asnjëherë nuk duhet ndalur së punuari për demokracinë.

Ne do të sigurohemi që kur të rritemi të kontribuojmë sa ma shumë në vendin tonë, sepse demokracinë e bëjmë ne.

jeve qytetarët zgjedhin deputetët, të cilët do t'i përfaqësojnë kërkesat e tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi është organ legjislativ i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Sipas ligjit, në Kosovë nuk mund të kandidosh për deputet apo të votosh në procese zgjedhore pa i mbushur 18 vjeç.

Kuvendi ndryshe quhet Pushteti Legjislativ. Quhet kështu, sepse si detyrë kryesore e Kuvendit është miratimi i ligjeve. Por, Kuvendi ka edhe detyra të tjera, e ato janë: zgjedhja e Qeverisë dhe kontrollimi i këtij



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ramadan Rexhepi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V
Website: www.demos-ti.org Vendi: Sojevë, Ferizaj